



PROCESVERBAL VIII/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII (tetë) për vitin 2022 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 23.08.2022
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimeve të çmimit “Ukë Bytyqi” ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01- Nr-016-20154 , të datës 30.03.2021 ;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës ;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alloimin e mjeteve nga fondi burimor (38),Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 në projektet kapitale ;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të Komunës ;**
- 7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e zyrës kombëtare të auditimit ;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;

Kryesuesi - pasi nuk ka vërejtje e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimeve të çmimit “Ukë Bytyqi” ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që ky komision do të ketë 5 anëtar,ku Kryesuesi shkon me automatizëm,kurse 2 vin nga Kuvendi ,1 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

Dardan Berisha - d.m.th. ju Kryesues shkon me automatizëm.

Urim Suka - a është një rregullore që e rregullon?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime,ku thotë:në vitin 2011 e kemi themeluar çmimin “Ukë Bytyqi” me vendim të Kuvendit dhe pas themelimit të çmimit e kemi miratuar rregulloren e cila përcakton procedurat për ndarjen e çmimeve. Gjithashtu është i paraparë themelimi i komisionit,ku komisioni do të ketë 5 anëtar,ku parashihet që Kryesuesi i Kuvendit të jetë Kryesues i komisionit që shkon me automatizëm.

Liridon Fandaj - a ndahet çmimi vetëm për një person apo si?

Avni Bytyqi - çmimi ndahet vetëm për një person dhe çmimi ka një vlerë financiare 3 mijë euro.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01- Nr-016-20154 ,të datës 30.03.2021 ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - a mundeni me na tregu për shkaqet pse po bohet dhe pse kanë kërku ata.Më duket nuk kemi pas kërkesa.

Avni Bytyqi - Për shkaqe teknike dhe të funksionalizimit sa ma të mirë të mundshëm për të ardhmen, kanë kërkuar me ndryshuar lokacionin në fshatin Budakovë me pikën 1.5,për shkak se nuk kanë dal në teren dhe nuk e kanë ditë që është teren i papërshtatshëm për me vendos trafon. Ata kanë gjete një teren që është ma i përshtatshëm dhe kanë pas kërkesë së pari gojarisht dhe pastaj i kam adresuar që kërkesa të jetë me shkrim për ta bërë plotësim-ndryshimin e vendimit. Për ne, besoj nuk ka pengesë ligjore sepse është në interes të qytetarëve dhe të Komunës.

Dardan Berisha - a po ndryshon vendimi vetëm për një parcelë, për trafostacion apo edhe shtylla elektrike?

Kryesuesi - vetëm për trafostacion.

Avni Bytyqi - në Nishor e kanë përfundu projektin. Në ara më nuk kanë leju shtylla elektrike dhe të gjitha janë drejtu rrugës kryesore.Të njëjtin projekt e kanë edhe për Budakovë.

Dardan Berisha - me sa e di çmimi është i përcaktuar.

Avni Bytyqi - Fatkeqësisht ligjin e kaluar kemi dhënë lokacione pa pagesë,mirëpo me ndryshimin ligjit nga qeveria, parashihet që asnjë pronë publike nuk mund të jepet pa kompensim. Vlera që e kemi parapa është një shumë simbolike.

Liridon Fanadaj - ato që janë dhënë më herët,a janë dhënë me një afat të caktuar?

Avni Bytyqi - po, 99 vite.

Dardan Berisha - ne si qytetarë duhet me bo një kërkesë sepse kemi probleme me çështjen e KEDS-it,sepse nuk intervenojnë me kohë dhe i neglizhojnë punët.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - kërkoj informacione shtesë për këto parcella.A kanë probleme ligjore,a janë të rregullta dhe a mundemi me vazhdu me procedura?

Armend Krasniqi - parcella në Bllacë është 5 hektar. Kemi konstatu që është e përshtatshme për mbjelljen e pemëve të imëta, po ashtu kemi konstatuar që nuk ka pengesa ligjore. Ndërsa në Samadraxhë është tokë e përshtatshme për mbjellje të vreshtit.Kushdo që keni interes me marrë toka bujqësore prej Komunës,si opozita dhe si pozita,është mirë me ngrit si çështje dhe tokat djerrina mi shndërrua në kultura që me kriju vende të reja të punës.

Urim Suka - në bazë të një udhëzimi administrativ,Komuna është e obliguar me i listu parcelat.Është mirë me marrë këtë udhëzim të ri dhe mi adresu këto çështje.

Armend Krasniqi - lista për dhënien në shfrytëzim të pronave çoftë afatshkurta apo afatgjata të Komunës së Suharekës ekziston që nga viti 2019.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth publikimit të listës së pronave dhe thotë që lista e përgjithshme e pronave është e publikuar që nga 2019.

Urim Suka - këto parcella që i keni pru,a janë prej listës apo në bazë të kërkesës?

Armen Krasniqi - patjetër që janë.

Liridon Fandaj - këto parcela, a kanë qasje në rrugë? Ne i japim dhe i merr dikush. Por mundet mos me pas qasje, dhe a ka mundësi ai me i bo padi Komunës.

Armend Krasniqi - çdo pronë ka të drejtë me pas qasje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alloimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 në projektet kapitale ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - nëse ju kujtohet atëherë kur u bë ri-alokimi, pata dhënë kritika që nuk është si duhet. Edhe tash ne po detyrohemi prap me bo ri-alokim njëjtë për mjetet të cilat nuk kanë kalu, për udhëzimin e njëjtë. Kjo po e tergon seriozitetin që ju nuk e keni. 100 mijë euro prej 10-tëshit dhe prej 21-shit 45 mijë euro-projekte me bashkëfinancim. Unë nuk e di se për çfarë projekti bëhet fjalë. A ka emër ky projekt? Pastaj 59 mijë euro- projekt me bashkëfinancim, projekti tjetër me bashkëfinancim 10 mijë euro. A ban me ja vendos emrin dhe ta dimë se ku po i qojmë këto pare. Te Kolektori, ju keni marrë një petition prej banorëve atje dhe përmes kësaj që e keni promovu, ju keni ngrit regimin qytetar në atë pjesë. Unë në parim jam që ajo rrugë me u rregullu. A ka diskutime publike? Sikur të ishte diskutu në dëgjime publike kjo, dhe sikur të njoftoheshin ata për pasojat e tyre, ndoshta s'do të kishte ardhur puna deri te petitionet dhe situatat që po krijohen. E kam thënë dhe po e them që ju po punoni pa plan dhe pa strategji. Për deri sa ne nuk kemi informata për projektet me bashkëfinancim se ku doni me i qu këto pare dhe për deri sa e kemi një situatë ku ju i keni trazur qytetarët atje, unë hezitohet me votu këtë projekt-vendim.

Sanije Kuqi Rexhepaj - dua të ndërlihem te pjesa ku Urimi flet për planifikim dhe strategjinë, dhe dua të ia rikujtoj që Komuna e Suharekës prej 2008 ka dokumente planifikuese, ka dokumente strategjike dhe prej 2008 rruga "Skënderbeu" është e planifikuar në zgjerim. Pajtohem me ty ku thoni që duhet me mbajtë diskutime publike për mi njoftu për një projekt shumë të rëndësishëm. Është ligjore me i njoftu qytetarët për atë pjesë sepse jam vet banorë e asaj lagje dhe jam pro për me e zgjeru atë rrugë sepse ajo rrugë është mjaft e ngarkomë. Pra mos thuaj që po punojmë pa planifikim dhe pa strategji sepse një staf i tërë profesionistësh janë marrë prej 2008 me planifikim dhe në PZHK është e planifikuar ajo rrugë. Ndërsa sa i përket bizneseve përreth që kanë investu në atë zonë, ata ka vite që e shfrytëzojnë një pjesë të pronës publike dhe nuk paguajnë asgjë.

Kryesuesi - unë si qytetarë i Suharekës minimum nja 10 herë jam taku me ata banorë në debate publike dhe një pjesë e vogël kanë dalë ndërsa pjesa dërmuese janë të kënaqur me atë investim.

Urim Suka - unë nuk po them që po punoni pa plan dhe strategji, pra nuk po du me thanë që ju s'keni dokumente të miratime. Ne e kemi miratu strategjinë për zhvillim ekonomik dhe lokal para tre muajsh, ku shkrun me investu me ndriçimin publik me solar, dhe Kryetari ka bo kontratë me vazhdu me investu me rrymë. -Nuk mora përgjigje për pjesën e bashkëfinancimit.

Dardan Berisha - kjo rrugë që ka me shku me faza, ne po e kalojmë fazën e parë dhe ka me u bo Kolektori qysh u bo edhe te sheshi. Ajo rrugë ka ngarkesa dhe u desh moti me përfundu. E di që është rrugë magjistrale dhe ka pengesa. Sa i përket dëgjimeve publike pajtohem me Urimin. Të gjitha bizneset pothuaj i kanë parkingjet në trotuar si tha edhe kolegja dhe ne nuk duhet ta politizojmë këtë çështje ose mu bo me biznesin sespe ne jemi duke e mbrojtë pronën e komunës.

Urim Suka - unë nuk jam kundër asaj rruge, por mënyrën si e keni prur dhe mënyrën se si keni nxit reagim qytetarë, pra është gabim.

Liridon Fandaj - Ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit është një tender që është hap dhe ka një vlerë, ku është ajo vlerë që janë planifiku mjetet. Tash ne, këto mjetet e bujqësisë pi qojmë veq për me mbulu atë tender apo cila është arsyeja? Për deri sa Ministria e jep një vendim dhe merr vendim që atë rrugë mos me bo sepse është kompetencë e Ministrisë dhe në anën tjetër del Kryetari dhe ju thotë bujqve se qeveria i ka hek mjetet. Por qeveria nuk i ka hek mjetet, qeveria ka thënë që planifikoi me një investim kapital në bujqësi.

Kryesuesi - a mundesh me dhanë sqarime në investime kapitale në bujqësi, p.sh. çka mujna me bo.

Liridon Fandaj - investim kapital është sistemi i ujitjes.

Kryesuesi - e kemi të planifikume.

Liridon Fandaj - e keni të planifikume vetëm për një fshat dhe ke mujt me planifiku edhe në fshatrat tjera në investim kapital dhe nuk e kish hek dhe jo në Kolektor.

Kryesuesi - por e kemi të planifikume.

Liridon Fandaj - A kish qenë më mirë mi qu 110 mijë euro në bujqësi apo mi qu në Kolektor.

Kryesuesi - kanë qenë në bujqësi dhe ti ka hek prej bujqësisë.

Urim Suka - asnjë projekt nuk e ki për mi nejt mbrapa atij 1 milion euroshi që don me bo në bujqësi. Ti ka kthi ministria dhe këto ndodhin. Por mos ngulni këmbë dhe pranoni që s'keni projekte për bujqësi. Kërkova sqarim për projektet me bashkëfinancim.

Avni Bytyqi - projektet me bashkëfinancim nuk mundet mi specifiku ky planifikim.

Liridon Fandaj - këtu thotë infrastrukturë rrugore në Suharekë, a janë këto projekte për infrastrukturë?

Avni Bytyqi - bashkëfinancimi është për të gjitha dhe nuk e specifikon infrastrukturën rrugore.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 5**

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të Komunës ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - është e njëjta situatë me vendimin paraprak, është i njëjti jozeriozitet. 924.000 euro nuk janë shfrytëzu në 2021 dhe jeni detyru mi bartë.

Kryesuesi - mbi 300.000 euro janë të hyra vetanake

Urim Suka - Përveq që i keni bart dhe nuk i keni shfrytëzu, tash kur e keni bo bartjen prap ministria i ka kthi për që pjesa e projekteve kapitale që kanë mbetur si keqklasifikim. Nuk e kam të qartë tabelën nr.1. ku thuhet: nga pjesa kapitale që nuk kanë kaluar janë dy projekte. Por këto dy projekte janë 48.000 euro dhe ne po flasim për 382.000 euro. Këto dy projekte prap i keni në investime kapitale, a u zgjidh problemi dhe a i kanë nënshkru kontratat? Te 109.000 euroshi i subvencioneve për bujqësi, juve ju kanë kthi njëherë. A keni mendu mirë dhe a kemi me bartë edhe një herë kah tetori.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 6**

Pika 7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e zyrës kombëtare të auditimit ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - ti nuk i ke zbatu, as nuk i ke marrë parasysh rekomandimet gjatë gjithë kohës kur ty t'ka ardhë në fund të qershorit raporti i auditimit. Mos është kohë e vonshme 31.12.2022 për mi zbatu rekomandimet.

Labinot Halitjaha - një pjesë të rekomandimeve kemi fillu mi zbatu dhe pjesa tjetër vazhdon deri në fund të vitit.

Urim Suka - nuk e kam sdudiu materialin e planit të veprimit në detale. Raporti i auditorit ka qenë shumë i qartë por ju nuk e keni vullnetin. Sipërfaqësisht plani i veprimit mu ka dok jo serioz. Në vazhden e qasjes që ju e keni dhe që s'po doni me ndryshu, sepse po doni me përfitu. Plot kontrata jam duke i pa. Do ti them edhe në Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim.

5 për, 2 apstenime

Miratohet pika 7.

Takimi përfundoi: **11:00**

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj